



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 521/2 prot

Datë 01.03.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-93325-01-17-2024, me objekt: “*Shërbim Netëorku për Trasmetimim e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe*”, me fond limit 19,366,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 07.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek SHA.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK, me NIPT (K62115018I), me adresë: Rruga e Qelqit, Kombinat, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Identitek ShA, me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “MC Networking” SHPK, me NIPT (K72223007O), me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Pjetër Bogdani”, Godina Nr. 3, Tiranë
- Operatori ekonomik “Communication Progress” SHPK, me NIPT (K01625001C), me adresë: Rruga “Stanislav Zuber”, Nd. 2, H.I9. Njësia administrative Nr. 7, 1023, Tiranë.

Në datën 01.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokoli 521 datë 01.03.2024 e operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-93325-01-17-2024, me objekt: “*Shërbim Netëorku për Trasmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe*”, me fond limit 19,366,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 07.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK me anë të ankesës me nr. protokoli 521/2024 datë 01.03.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

*Shtojca 8*

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

**1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

[...]

*Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

***Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.***

[...]

*Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

.....  
**2.3 Kapaciteti teknik:**

3. *Operatori ekonomik për zbatimin e kontratës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij jo më pak se 20 (njëzet) punonjës të diplomuar në fushën e Telekomunikacionit, Elektronikë, Informatike, Teknologji Informacioni, Elektrike, ose ekuivalente, të cilët do të kryejnë shërbimin instalimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjen e shërbimit. Për punonjësit e sipërcituar duhet të paraqes:*

- *Kontratë pune individuale;*
- *Diplomë përkatëse;*
- *Çertifikata kualifikimi (nëse disponojnë)*
- *Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse.*

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimes pretendon se oferta e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK është anomalisht e ulët.

Në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Communication Progress” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

*Shtojca 8*

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*  
**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**  
**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

[...]

*Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

***Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.***

[...]

*Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

.....  
Operatori ekonomik ankimues pretendon duke cituar se: “[...] *Communication Progress* nuk disponon Ripe NÇ për ofrimin e shërbimit bazuar në kërkesat e specifikimeve teknike. Kjo kompani ka një natyrë tjetër shërbimesh që ofron gjithashtu nuk asnjë rrjet fibre optike në asnjë nga qytete e Shqipërisë.”

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues pretendon se oferta e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK është anomalisht e ulët.

Akoma me tej, operatori ekonomik ankimues ngre pretendime për parregullsi të procedurës së prokurimit publik nga ana e autoritetit kontraktor.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 01.03.2024.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**